



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO

REPUBLIC OF KOSOVO

Kuvendi Komunal Dragash – Skupština Opštine Dragaš –
Municipality of Dragash



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (c), nenit 17, pika (f), nenit 40 paragrafi 2, pika (a) dhe (g), të Ligjit Nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, nenit 8, pika a, nenit 15 pika f, dhe nenin 19 paragrafi 1, të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, neneve 15 dhe 34, të Ligjit Nr. 04/L-60, për mbeturina dhe për ndryshimin dhe plotësimin Ligji Nr.08/L-071, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2011” dhe dispozitat nenit 28, lidhur me nenin 29, të Statutit të Komunës së Dragashit, 01.Nr.06-103/1, të datës 11.09.2008, Kuvendi i Komunës së Dragashit, në mbledhjen e mbajtur me datën 25.06.2026 miratoi këtë:

**RREGULLORE PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E RREGULLORES
PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE 01.NR.060/01-22757-1/24 E DATËS 30.08.2024**

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është plotësim-ndryshimi i Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave me nr. të protokollit 01Nr.060/01-22757-1/24, të datës 30.08.2024.

Neni 2

Ndryshimi i nenit 20

Neni 20 i Rregullores bazë për Menaxhimin e Mbeturinave me nr. të protokollit 01Nr.060/01-22757-1/24, të datës 30.08.2024, riformulohet si vijon:

Dispozitat Ndëshkuese – Gjobat

2.1. Ndaj gjeneruesit të mbeturinave, i cili nuk e kryen pagesën e taksës për mbeturina brenda afateve të përcaktuara, do të iniciohen procedurat ligjore për arkëtimin e borxhit, përfshirë procedurën gjyqësore dhe procedurën përmbartimore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2.2. Për shkelësit e dispozitave të kësaj Rregulloreje, inspektori komunal shqipton gjoba mandatore në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina.

Neni 3

Ndryshimi i Shtojcës A

Në Shtojcën A të Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave me nr. të protokollit 01Nr.060/01-22757-1/24, të datës 30.08.2024, në Tabelën 1, te kategoria “Amvisëri”, tarifat e taksës për mbeturina ndryshohen si vijon:

Tarifat mujore	6,50€ njësi familjare resident 4,50€ individë
Tarifat vjetore	30,00€ jo resident (mërgata)

Neni 4

Rregullorja për Plotësim ndryshimi i Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave 01Nr.060/01-22757-1/24 e datës 30.08.2024 në fuqi 30 ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8 dhe nenit 9 të Ligjit Nr.08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 24/2024” dhe pas publikimit në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS - DRAGASH

01 Nr. 06d01-11872-2126

Dt. 25.06.2026

Kryesuesi i Kuvendit
Resul Fetahu

